



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 11.10.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-946/24, për zyrtarin z. Ilaz Kadrijaj, ud. Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami” në Shtime, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin publik z. Ilaz Kadrijaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/1-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

“[...] “Më datë 30.05.2024, kryetari i Komunës, Qemajl Aliu, në mënyrë të kundërligjshme ka emëruar, Ilaz Kadrijajn, UD të drejtorit të DSHM-së, pasi që i njëjti mban edhe pozitën e UD të drejtorit të QKMF-së në Shtime” [...]

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes shkresës zyrtare APK-DPKI-06-1220/24, e ka njoftuar zyrtarin z. Ilaz Kadrijajn, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Po ashtu përmes emailit Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga Komuna e Shtimes informatat lidhur me funksionin e Drejtorit Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami” në Shtime.

Në përgjigje të kërkesës së Agjencisë, Komuna e Shtimes njofton se:

“[...] Drejtor të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Shtimes është M.S.Q, ndërsa Ilaz Kadrijaj është ushtrues detyre i Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr Vezir Bajrami” në Shtime. Më pas ka dërguar edhe nga një kopje të: Vendimit nr.02/527 datë 30.05.2024 me të cilin autorizohet u.d i Drejtorit të Qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami” në Shtime, z. Ilaz Kadrijaj për kryerjen e detyrave dhe

përgjegjësi në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Shtimes dhe Vendimin nr. 02/850 datë 09.08.2024 me të cilin shfuqizohet vendimi nr. 02/527 i datës 30.05.2024 sipas të cilit z. Ilaz Kadrijaj ishte autorizuar për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Shtimes".

Pas shqyrtimit të dokumentacionit/informacionit në dispozicion si dhe gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në dispozitat e LPKI-së si dhe informatat e siguruara nga Komuna e Shtimes, konstaton se:

Në situatën konkrete nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke marrë parasysh faktin se, që nga data 09.08.2024, z. Ilaz Kadrijaj nuk ushtron më detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Shtimes. Pasi që tani më kanë pushuar së ekzistuari arsyet për të cilat është filluar hetimi administrativ e me këtë pushohet edhe procedura e hetimit administrativ për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit]¹.

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *"Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë"*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *"Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Ylli BULESHKAI
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

¹ Vendimit Nr. 02/850, datë 09.08.2024 me të cilin shfuqizohet vendimi nr. 02/527, i datës 30.05.2024 sipas të cilit z. Ilaz Kadrijaj ishte autorizuar për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Shtimes